

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 4-2020

ZHVILLIMI I SISTEMIT SË QEVERISË ELEKTRONIKE (E-QEVERISJA)

Bardh Fetahu

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Management Information Systems Commons](#)



Kolegji UBT

Fakulteti i Sistemeve të Informacionit

**ZHVILLIMI I SISTEMIT SË QEVERISË ELEKTRONIKE (E-
QEVERISJA)**

Shkalla Bachelor

Bardh Fetahu

Prill / 2020

Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti i Sistemeve të Informacionit

Punim Diplome
Viti akademik 2017-2018

Bardh Fetahu

**ZHVILLIMI I SISTEMIT SË QEVERISË ELEKTRONIKE (E-
QEVERISJA)**

Mentor: Phd. Blerton Abazi

Prill / 2020

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjesëshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Në këtë punim do të trajtohet kuptimi, zhvillimi, analiza dhe vlersimi i qeverisë elektronike (E-Qeverisja). Me zhvillimin e teknologjisë jeta në përgjithësi është përmisuar dukshëm duke gjetur zbatim në shumë fusha, duke i ndihmuar organizatave të ndryshme në lehtësimin e punëve dhe në përsheptimin e tyre. Teknologjia ka gjetur zbatim shumë të madh dhe shumë të rëndësishëm edhe në fushën e E-Qeverisë, duke e bërë shumë më të lehtë ndërveprimin mes qytetarëve dhe qeverisë së tyre, mes qeverisë dhe agjensioneve tjera qeverisëse, mes qeverisë dhe qytetarëve, mes qeverisë dhe të punuarëve dhe poashtu mes qeverisë dhe bizneseve. Gjithashtu në këtë punim do të shpjegohet roli dhe funksioni i teknologjive në mundësimin e E-Qeverisjes si dhe ndërlidhja e tyre. Shtjellimi i fazave nëpër të cilat kalon E-Qeverisja, si dhe do të shpjegohen modelet dhe dobitë e E-Qeverisjes në mënyrë që lexuesit të kenë më të lehtë ta kuptojnë se çka është E-Qeverisja, ndikimi i saj në jetët e njerëzve, sfidat e E-Qeverisjes, si funksionon ajo dhe rëndësinë e saj në kohën moderne në të cilën ne po jetojmë.

MIRËNJOHJE DHE FALENDËRIME

Fillimisht dëshiroj të falënderoj familjen time, prindërit Teuta dhe Brahim, vëllaun Genci si dhe të dashurën time Venera, të cilët më mundësuan që të studioj me përkrahjen e tyre të sinqertë financiare dhe morale.

Poashtu dëshiroj të falënderoj Kolegjin UBT, për mundësinë dhe kushtet të cilat më janë ofruar që të mësoj dhe të zhvillohem në drejtimin e Sistemeve të Informacionit.

Njëri ndër personat më të veçantë, gjatë studimeve të mija ishte mentori im Phd. Blerton Abazi, të cilin e falënderoj me shumë sinqeritet dhe respekt, për gjithë kohën e kushtuar ndaj meje gjatë studimeve e sidomos gjatë punimit të temës së diplomës ku me këshillat, idetë, udhëzimet, mirëkuptimin dhe motivimin e tij kam arritur që ta përfundoj këtë punim me sukses.

Falendërime të përzemerta shkojnë edhe për shokët dhe shoqet që më ndihmuan gjatë studimeve dhe më motivuan për realizmin e këtij punimi.

Dhjetor, 2019

Prishtinë

TABELA E PËRMBAJTES

LISTA E FIGURAVE	IV
LISTA E TABELAVE.....	V
FJALORI I TERMAVE.....	VI
1 HYRJE.....	1
2 SHQYRTIMI I LITERATURËS	2
2.1 Terminologjia dhe objektivat e qeverisjes elektronike (E-Qeverisja)	2
2.2 Modelet e E-Qeverisjes	5
2.3 Fazat e E-Qeverisjes	10
2.4 Teknologjia në E-Qeverisje.....	13
2.4.1 Kriteret për dizajnin e një infrastrukture për E-Qeverisje	14
2.4.2 Infrastruktura e Teknologjisë informative në E-Qeverisje.....	18
2.5 Siguria e informacionit në E-Qeverisje.....	22
2.5.1 Sfidat teknike të Sigurisë	24
2.5.2 Sfidat jo-teknike të Sigurisë	26
2.5.3 Faktorët e suksesit të Sigurisë në E-Qeverisje.....	28
2.6 Barrierat ndaj zhvillimit dhe zbatimit të E-Qeverisjes	30
3 DEKLARIMI I PROBLEMIT	33
4 METEDOLOGJIA	34
5 PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE	35
5.1 Një sistem efektiv për zhvillimin e E-Qeverisjes në shtetet në zhvillim.....	35
6 KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET	38
7 REFERENCAT.....	39

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Karakteristikat e shërbimit elektronik G2C	6
Figura 2: Benefitet e punëtorve nga shërbimi elektronik G2E	10
Figura 3: 4 fazat e zhvillimit të E-Qeverisjes nga Gartner	13
Figura 4: Disa ngarkesa tipike në një website gjatë një periudhe 24-orëshe (“IBM analysis for four e-business websites”)	16
Figura 5: Projekti i infrastrukturës së IT për një e-qeverisje	19
Figura 6: Sfidat e Sigurisë së e-Qeverisjes	23
Figura 7: Një sistem efektiv për zhvillimin e E-Qeverisjes në shtetet në zhvillim..	35
Figura 8: Lulatja e kostove të kërkuara dhe përpjekeve në faza të ndryshme	37

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Indeksi i zhvillimit të E-Qeverisjes në kuadrin e regjioneve globale në vitin 2018	3
Tabela 2: Top 10 shtetet me numrin më të madh të përdoruesve të internetit në vitin 2016	31

FJALORI I TERMAVE

E-Qeverisja - Qeverisja Elektronike

OECD - Organisation for Economic Co-operation and Development

TIK - Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit

G2C - Government to Citizens

G2B - Government to Business

G2E - Government to Employers

G2G - Government to Government

GSA - General Services Administration

IRS - Internal Revenue Services

TCP - Transmission Control Protocol

IP - Internet Protocol

HTML - Hypertext Markup Language

SSL - Secure Sockets Layer

DAS - Direct Attached Storage

NAS - Network Attached Storage

SAN - Storage Area Networks

PKI - Public Key Infrastructure

BCA - Bridge Certification Authority

VPN - Virtual Private Network

LAN - Local Area Network

UDP - User Data Protocol

1 HYRJE

Me revolucionin mbarëbotërorë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, interneti, kompjuterët, laptopët, telefonat e mençur si dhe të gjitha paisjet teknologjike të mençura po ndikojnë rrënjësisht në ndryshimin e jetës tonë se si ne punojmë, mesojmë dhe bashkëveprojmë. Ndërmjet shumë premtimeve të revolucionit digjital, më i prekshmi është ai i forcimit të proceseve dhe kapaciteteve demokratike të një vendi. Ai e shndërron qeverisjen duke e bërë atë më të përgjegjshme dhe më të gatshme për t'u përgjigjur nevojave të qytetarëve. E-Qeverisja apo qeverisja elektronike, është një ndër fushat më premtuse të përdorimit të teknologjisë së informimit dhe të komunikimit. Qeveritë në të gjithë botën po i shfrytzojnë teknologjitë në mënyrë që të krijojnë vlera të qeverisë elektronike, duke i hartuar dhe zbatuar në mënyrën më të mirë.

Qeveria elektronike apo E-Qeveria, rritë efikasitetin e bashkëveprimit me qytetarët e saj, agjensionet qeveritare dhe bizneset e ndryshme, duke e përmisuar ofrimin e shërbimeve qeveritare dhe duke thjeshtuar përputhjen me rregulloret e qeverisë, ndihmon në pjesëmarrjen më të madhe të qytetarëve si dhe në besimin më të madh ndaj qeverisë duke e bërë veprimtarinë e saj më transparente, kështu duke zvogëluar mundësitë për korrupsion dhe rritjen e mundësive për zhvillim, sidomos për zonat rurale të prapambetura. E-qeverisja përfshin qasje më të madhe të informacionit qeveritar në të gjitha llojet e informacionit që ka lidhje me qeverisjen e të gjitha niveleve. E-Qeverisja nuk është një mjet të cilin mund ta përdorin vetëm vende të pasura. Madje, në të vërtetë, disa nga përdorimet me efektive dhe inovative të Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit janë aplikuar në vendet në zhvillim, duke e sjelle qeverisjen me afër qytetarëve dhe duke luftuar fenomenet negative si korrupsioni apo mungesa e transparencës.

Qëllimi i këtij punimi është që të shpjegohet më thellë se çka është kuptimi i E-Qeverisjes, cila është rëndësia e saj, si ndikon ajo në jetën e qytetarëve, roli i teknologjisë në zhvillimin e E-Qeverisjes, modelet, fazat, siguria dhe ndërlidhja e tyre me njëra tjetrën për funksionimin e E-Qeverisjes. Për t'u përgjigjur në këto pyetje do të përdoren metodat kualitative dhe kuantitative, si dhe raste studimore.

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Terminologjia dhe objektivat e qeverisjes elektronike (E-Qeverisja)

E-Qeverisja njihet gjithashtu me terma të ndryshëm si Qeveria Elektronike, Qeverisja Elektronike, Qeveria Dixhitale, Qeveria Online, e-Gov etj. (Grönlund, 2004). Në fakt, ka shumë përkufizime për termin Qeverisja elektronike dhe ndryshimet reflektojnë përparësitë në strategjitë e qeverisë. (Fang, 2002) e përcaktoi qeverisjen elektronike si një mënyrë për qeveritë që të përdorin informacionin dhe teknologjitë më inovative të komunikimit, veçanërisht aplikacionet e bazuara në internet, për t'u ofruar qytetarëve dhe bizneseve qasje më të përshtatshme në informacionin dhe shërbimet qeveritare, për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe të sigurojë mundësi më të mëdha për të marrë pjesë në institucione dhe procese demokratike. Për më tepër, termi "e-qeverisje", siç përdoret nga Projekti i E-Qeverisë nga OECD, vlen për përdorimin e TIK-ut si një mjet për të arritur një qeverisje më të mirë. Prandaj, qeveria elektronike nuk ka të bëjë me biznesin si zakonisht, por duhet në vend të kësaj të përqëndrohet në përdorimin e TIK-ut për të transformuar strukturat, operacionet dhe, më e rëndësishmja, kulturën e E-Qeverisjes. E-Qeverisja elektronike përdor TIK-un si një mjet mbështetës në zhvillimin e qeverisjes së mirë. Zbatimi i duhur i qeverisë elektronike lejon nivele më të larta të efektivitetit dhe efikasitetit në detyrat qeveritare, përmirësimin e proceseve dhe procedurave, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike, gjithashtu përmirëson përdorimin e informacionit në proceset e vendimmarrjes dhe lejon komunikim më të mirë midis zyrave të ndryshme qeveritare.

Tabela 1: Indeksi i zhvillimit të E-Qeverisjes në kuadrin e regjioneve globale në vitin 2018

Regjioni	Rezultati i Indexit
Amerika	0.59
Asia	0.58
Evropa	0.53
Oqeania	0.46
Afrika	0.34
Mesatarja Botërore	0.55

Burimi: (Statista, 2018)

Nga tabela, ne mund të kuptojmë se trendi i zhvillimit të E-Qeverisjes është duke u rritur nga viti në vit dhe regjionet si : Amerika, Azia dhe Evropa janë me zhvillimin më të madh të E-Qeverisjes, ndërsa regjioni i Afrikës shihet se ka zhvillim më të ulët.

Për qëllimin e qeverisjes elektronike, ekziston një dallim i qartë midis objektivave për proceset (operacionet) e brendshme dhe objektivave për shërbimet e jashtme, këto klasifikohen në dy strategji objektivash të cilat janë:

1. **Strategjia e objektivave të jashtme:** Objektivi i jashtëm i qeverisë elektronike, do të përmbushë në mënyrë të kënaqshme nevojat e publikut dhe pritjet e tyre nëpër zyre të ndryshme qeveritare, duke thjeshtuar bashkëveprimin e tyre me shërbime të ndryshme të ofruara në internet. Përdorimi i TIK-ut në operacionet qeveritare përmes: shpejtësisë, transparencës, përgjegjësisë, efikasitetit dhe efektivitetit lehtëson bashkëveprimin me publikun, qytetarët, biznesin dhe agjencitë e tjera.
2. **Strategjia e objektivave të brendshme:** Objektivi i brendshëm i qeverisë elektronike në proceset (operacionet) qeveritare është për të lehtësuar në mënyrë më të shpejtë, më transparente, të përgjegjshme dhe të efektshme në kryerjen e aktiviteteve të administrimit të qeverisë, dhe ulje të konsiderueshme të kostos në shërbime.

Thelbi i qeverisjes së mirë bazohet në premisat që ligjet dhe procedurat të jenë transparente, të përcaktuara dhe kuptuara qartë nga të qeverisurit dhe implementimi të jetë i shpejtë.

Ashtu si interneti, qeveria elektronike premtion të ofrojë një numër përfitimesh për qytetarët, bizneset, puntorët dhe agjensitë qeveritare. Përfitimet më domethënëse dhe kryesore të qeverisë elektronike për këta përfitues janë:

Përfitimet e qytetarëve dhe të punësuarve:

- Lehtësia e qasjes: Nuk ka më rradhë të pritjes, E-Qeverisja ju shërben kudo dhe në çdo kohë.
- Qasje në më shumë informacione : Duke përdorur të njëjtin lloj të ndërfaqjes, mund të qaseni në çdo lloj informacioni, kudo në çdo kohë.
- Më shumë forma të pjesëmarrjes ndaj qeverisë: Inkjuarimi i debatit online dhe shkëmbimi i informacioneve.

Përfitimet e bizneseve:

- Qasje më të madhe në informacione të shumta.
- Ndërveprim i thjeshtë me agjensitë përkatëse.
- Nxitja e zhvillimit ekonomik dhe ndihma e bizneseve lokale për zgjerim global.
- Kosto e ulët e transaksioneve dhe dokumenteve.

Përfitimet e qeverisë dhe agjensioneve qeveritare:

- Rritja e efikasitetit.
- Vlerësim i rritur
- Ulja e mundësive për korrupsion
- Krijimi i shërbimeve që mbulojnë sa më shumë një spektër të shoqërisë.
- Rindërtimi i marrëdhënieve me klientët duke siguruar vlerat e shtuara dhe shërbimet e personalizuar për qytetarët.
- Kosto e ulët transaksioneve dhe dokumenteve.
- Komunikim i përmirësuar brenda departamentit.
- Përhapja e shërbimeve të ngjashme për të gjithë.
- Transparencë më e madhe në funksionimin e qeverisë.

2.2 Modelet e E-Qeverisjes

E-qeveria u ofron shërbime atyre që janë të autorizuar për të lidhur transaksione elektronike me qeverinë. Këto shërbime ndryshojnë në bazë të nevojave të përdoruesve, dhe kjo larmi ka dhënë zhvillimin e modeleve të ndryshme të E-Qeverisjes. Modelet e E-Qeverisjes mund të klasifikohen në katër kategori kryesore:

- Qeveria ndaj Qytetarëve (G2C)
- Qeveria ndaj Bizneseve (G2B)
- Qeveria ndaj Qeverive (G2G)
- Qeveria ndaj Puntorëve (G2E)

Qeveria ndaj Qytetarëve (G2C)

Shumica e shërbimeve qeveritare janë nën këtë aplikim, në drejtim të sigurimit të qytetarëve dhe të tjerëve përmes burimeve elektronike gjithëpërfshirëse për t'iu përgjigjur shqetësimeve rutinore të individëve dhe transaksioneve qeveritare. Qeveria dhe qytetarët do të komunikojnë vazhdimisht kur zbatojnë qeverinë elektronike, duke u mbështetur kështu përgjegjshmëria, demokracia dhe përmirësimet në shërbimet publike. Qëllimi kryesor i E-Qeverisjes është të i shërbejë qytetarit dhe të lehtësojë ndërveprimin e qytetarëve me qeverinë duke bërë të arritshme më shumë informacione publike përmes përdorimit të faqeve të internetit, si dhe zvogëlimin e kohës dhe kostos për të kryer një transaksion (Ndou, 2004). Në zbatimin e idesë së G2C, klientët kanë qasje të menjëhershme dhe të përshtatshme në informacionet e qeverisë dhe shërbime nga kudo në çdo kohë, përmes përdorimit të kanaleve të shumta. Përveç sigurimit të transaksioneve siç janë: çertifikatat, pagimi i tarifave qeveritare dhe aplikimi për përfitime, aftësia e G2C krijon iniciativa për të kapërcyer kohën e mundshme dhe pengesat gjeografike për të lidhur qytetarët që nuk mund të vijnë në kontakt me njëri-tjetrin dhe nga ana tjetër mund të lehtësojnë dhe të rrisin pjesëmarrjen e qytetarëve në qeveri (Seifert, 2003).

Forcat Motivuese Prapa Sektorit G2C. Interesimi për nismat e G2C drejtohet nga një kombinim i disa faktorëve. Njëra është kërkesa e qytetarëve, veçanërisht nga qytetarët e rinj dhe ata që janë mësuar të përdorin transaksione elektronike në fusha të tjera të jetës së tyre (p.sh., sistemi bankar). Disa vëzhgues presin që kërkesa e qytetarëve për E- Qeverisje të rritet ndjeshëm gjatë dhjetë viteve të ardhshme, si të rinjtë të cilët tani janë duke u rritur me kompjutera personale dhe internetin si një prani në rutinën e jetës së tyre.




Figura 1: Karakteristikat e shërbimit elektronik G2C

Përfitimet për qytetarët nga shërbimet në internet:

- Kostoja e ulët dhe kohë e kursyer
- Kualitet më i mirë në shërbime
- Qasje e lehtë në informacione
- Kanale të shumëfishta shpërndarëse
- Mundësi e vetshërbimit
- Më pak korrupsion

Shembuj të Nismave të G2C . Edhe pse shumë shembuj të nismave të G2C mund të gjenden në nivelin lokal dhe shtetëror, ka edhe shembuj në nivelin federal. Një nga këto shembuj është krijimi i Webfaqes së FirstGov. FirstGov paraqet partneritetin publik-privat dhe administrohet nga GSA (General Services Administration). Themeluar në Shtator 2000, FirstGov është krijuar për të shërbyer si portal online për 51 milion faqe

informacione qeveritare, shërbime dhe transaksione në internet. Sipas Webit faqja FirstGov ka kërkimin më të plotë të qeverisë kurdo dhe kudo që ndodhet interneti. Krijuesit e tij shpresojnë gjithashtu se FirstGov do të shërbejë si katalizator për një qeveri elektronike në rritje.

Një shembull i dytë është IRS (Internal Revenue Services). Përveç sigurimit të të gjitha formave të taksave IRS në internet për shkarkim, uebfaqja IRS gjithashtu përmban një mori informacionesh për t'u përgjigjur një larmi pyetjesh që lidhen me taksat që qytetarët normalisht mund të bëjnë gjatë një telefonate në një Linjë të ndihmës telefonike IRS ose vizita në një nga qendrat e saj. IRS gjithashtu lejon qytetarët dhe bizneset të paraqesin dhe paguajnë taksat e tyre në internet duke përdorur një opsion të quajtur “skedar elektronik”. Në varësi të situatës tatimore të një personi, skedari elektronik mund t'i mundësojë një filer të paraqes informacione, bëni pagesa dhe merrni rimbursime në mënyrë elektronike.

Qeveria ndaj Bizneseve (G2B)

Qeveria ndaj biznesit ose G2B, është lloji i dytë kryesorë i kategorisë së qeverisë elektronike. G2B mund të sjellë efikasitete të konsiderueshme si për qeveritë ashtu edhe për bizneset. G2B përfshinë shërbime të ndryshme të këmbyerave ndërmjet qeverisë dhe sektorëve të biznesit, përfshirë shpërndarjen e politikave, memorandumëve, rregullave dhe rregulloret. Shërbimet e ofruara të biznesit përfshijnë marrjen e informacionit aktual të biznesit, rregullore të reja, shkarkimi i formularëve të aplikimit, vendosja e taksave, rinovimi i licencave, regjistrimi i bizneseve, marrja e lejeve, dhe shume të tjera.

Shërbimet e ofruara përmes transaksioneve G2B gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillim biznesi, konkretisht zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (*Pascual, 2003*). (*Fang, 2002*) argumenton se aplikacionet G2B drejtojnë në mënyrë aktive nismat e transaksionit elektronik siç janë prokurimi elektronik dhe zhvillimi i një tregu elektronik për blerjet e qeverisë, dhe të kryejë prokurimin e qeverisë dhe të tenderëve përmes mjeteve elektronike për shkëmbimin e informacionit dhe mallrave. Ky sistem përfiton nga qeveria nga përvojat në internet të biznesit në fusha të tilla si strategjitë e marketingut elektronik. Sistemi G2B është po aq i dobishëm sa sistemi G2C, duke rritur efikasitetin

dhe cilësinë e komunikimit dhe transaksioneve gjithashtu bashkë me të rritet edhe biznesi, ajo rritë barazinë dhe transparencën e kontraktimit të qeverisë dhe projekteve (Moon, 2003).

Shërbimet e G2B janë:

- Prokurimi qeveritar
- Prokurimi elektronik në marketplace
- Ankandet
- E-Mësimi (Mësimi elektronik)
- Format e përfshirjes elektronike
- Përditimi i informacionit të korporatave
- Dërgimi i formave elektronike të pambushura (format e taksës, format e sigurimit shëndetsor etj.)
- Dërgimi i pagesave elektronike
- Dërgimi dhe pranimi i përgjigjeve në mënyrë elektronike
- Takimet on-line

Shembull i Nismave të G2B. Një shembull i një nisme G2B është GSA Ankandet. Ankandi i GSA-së është një faqe në internet në të cilën GSA shet pronat e tepërta federale ndaj ofertuesve më të lartë. Artikujt e shitur përfshijnë gjithçka nga dora, mjetet dhe paisjet për makineri industriale dhe automjete.

Qeveria ndaj Qeverive (G2G)

Qeveria ndaj Qeverisë (G2G) është ndërveprimi jo-komercial në internet midis organizatave qeveritare, departamenteve dhe autoriteteve. Kjo i referohet komunikimeve në internet midis organizatave qeveritare, departamenteve dhe agjensioneve bazuar në një bazë të dhënash super-qeveritare. Për më tepër, i referohet marrëdhënies midis qeverisë dhe punonjësve të saj siç përshkruhen më poshtë. Efiqenca dhe efikasiteti i proceseve

përmirësohet me përdorimin online të komunikimit dhe bashkëpunimit të cilat lejojnë ndarjen e bazave të të dhënave, burimeve dhe shkrijen e tyre në kapacitete dhe aftësi. Ai jep informacione në lidhje me kompensimin dhe politikat e përfitimit, trajnimit dhe mundësitë e të mësuarit dhe ligjet e të drejtave civile në një mënyrë lehtësisht të arritshme (Ndou, 2004). Qëllimi jetik i zhvillimit të G2G është të organizoj dhe përmirësoj proceset organizative ndër-qeveritare duke thjeshtuar bashkëpunimin dhe kordinimin. Në një aspekt tjetër G2G ofron përdorimin e teknologjive të informacionit nga agjensione të ndryshme qeveritare për të shkëmbyer ose centralizuar informacionin, ose për të automatizuar dhe drejtuar proceset ndërqeveritare të biznesit të tilla si rregullatorët e pajtueshmërisë, kanë prodhuar raste të shumta të kursimit të kohës dhe kostos dhe përmirësimin e shërbimeve (Gregory, 2007).

Sistemet e G2G zakonisht shpjegohen në dy lloje:

1. Përballja e brendshme – bashkimi i një departamenti, agjencionit, organizatës dhe autoritetit qeverisës, shembujt përfshijnë aspektin e integritit të portës së qeverisë.
2. Përballja e jashtme – bashkimi i shumë Sistemeve të informacionit së qeverisë.

Qeveria ndaj Puntorëve (G2E)

Qeveria tek punonjësit është sektori më i vogël i qeverisë elektronike në shumë hulumtime të qeverisë elektronike. Disa studiues e konsiderojnë atë si një pjesë të brendshme të sektorit G2G dhe të tjerët merren me të si një sektor i veçantë i qeverisjes (Riley, 2001). G2E i referohet marrëdhënieve midis qeverisë dhe punonjësve. Qëllimi i kësaj marrëdhënie është t'u shërbejë punonjësve dhe të ofrojë disa shërbime në internet, siç është aplikimi në internet për një pushim vjetorë, duke kontrolluar bilancin e pushimit, dhe rishikimin e regjistrave të pagave, ndër të tjera (Seifert, 2003), është një ndërthurje e informacionit dhe shërbimeve që ofrohen nga institucionet qeveritare ndaj punëtorve për të bashkëvepruar me njëri-tjetrin dhe menaxhimin e tyre.

G2E është një mënyrë e suksesshme për të siguruar mësimin elektronik, bashkon punonjësit dhe inkurajon shkëmbimin e njohurive midis tyre. Ajo u jep punonjësve mundësi të përdorimit të informacionit përkatës në lidhje me kompensimin dhe politikat e përfitimeve, trajnimeve dhe mundësitë e të mësuarit, dhe duke u lejuar atyre qasje për

të menaxhuar përfitimet e tyre në internet me një model të shpejtë dhe të lehtë të komunikimit. G2E gjithashtu përfshinë mekanizma strategjik dhe taktikë për inkurajimin dhe zbatimin e qëllimeve dhe programeve të qeverisë, si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, buxhetimin dhe lidhjen me qytetarët (Ndou, 2004).




Figura 2: Benefitet e punëtorve nga shërbimi elektronik G2E

2.3 Fazat e E-Qeverisjes

Përveç identifikimit të nismave të qeverisë elektronike, sipas sektorit të tyre, të tilla projektet gjithashtu mund të klasifikohen në bazë të nivelit të tyre ose fazës së zhvillimit. Megjithëse nisma të ndryshme të qeverisë elektronike përpiqen të arrijnë qëllime të ndryshme, disa vëzhgues argumentojnë se një nga temat kryesore të qeverisjes elektronike është që plotësisht të realizojnë aftësitë e teknologjisë së informacionit në dispozicion në përpjekje për t'u shndërruar qeveria nga një operacion shërbimi i kufizuar në agjensi, në një automatizëm operimi i përqendruar në qytetar që është i aftë për të ofruar shërbime qeveritare drejt qytetarëve, bizneseve dhe agjensioneve të tjera qeveritare 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë. Sidoqoftë, për një larmi arsyesh teknike, ekonomike dhe politike, do të duhet kohë që këto iniciativa të evoluojnë në potencialin e tyre të plotë. Për këtë arsye, disa vëzhgues përdorin një skemë të përbashkët për klasifikimin e fazave

të evolucionit të projekteve të qeverisjes (*Christopher Baum, Andrea Di Maio, 2000*). Skema bazohet në shkallën në të cilën pronat e teknologjisë së informacionit janë përdorur për të mundësuar shpërndarjen e shërbimeve elektronike.

Duke përdorur këtë skemë, ekzistojnë katër faza të evolucionit:

- Prezenca
- Bashkëveprimi
- Transaksioni
- Transformimi

Prezenca

Prezenca është faza e parë e zhvillimit dhe është krijimi i një mbajtësi të vendndodhjes për dhënien e informacionit në të ardhmen. Ajo përfaqëson qasjen më të thjeshtë dhe më së paku të kushtueshme në qeverinë elektronike, por gjithashtu ofron opsionet më të pakta për qytetarët. Një shembull tipik është një faqe interneti themelore që rendit informacionin rreth një agjensie, të tilla si orët e funksionimit, adresa e postës dhe numrat e telefonit, por nuk ka aftësi interaktive. Ëhtë një prezantim pasiv i informacionit të përgjithshëm. Disa vëzhgues i referohen këtyre llojeve të faqeve si 'broshurë,' duke sygjyeruar se janë ekuivalencë elektronike të një broshure letre.

Bashkëveprimi

Faza e dytë është bashkëveprimi. Megjithëse nismat interaktive me bazë në Web ofrojnë mundësi të zgjeruara, përpjekjet në këtë grup janë ende të kufizuara në aftësinë e tyre për të drejtuar dhe automatizuar funksionet e qeverisë. Ndërveprimet janë relativisht të thjeshta dhe përgjithësisht sillen rreth sigurimit të informacionit. Këto lloj iniciativash janë krijuar për të ndihmuar klientin të shmang një udhëtim në një zyrë ose të bëjë një telefonatë, ato ndihmojnë në vënien në dispozicion të informacionit dhe formave të kërkuara zakonisht gjatë gjithë orarit. Këto burime mund të përfshijnë udhëzime për marrjen e shërbimeve, forma të shkarkueshme për t'u shtypur dhe dërguar me postë në

një agjensi, ose ndoshta kontakt me postë elektronike për t'u përgjigjur pyetjeve të thjeshta.

Transaksioni

Faza e tretë në evolucionin e nismave të qeverisë elektronike është transaksioni. Këto iniciativa janë më komplekse sesa sigurimi i thjeshtë i informacionit dhe mishërojnë llojet e veprimtarive që shoqërohen në mënyrë popullore me qeverinë elektronike. Ato u mundësojnë klientëve të plotësojnë detyra të tëra në mënyrë elektronike në çdo kohë të ditës ose natës. Këto nisma krijojnë në mënyrë efektive operacione të vetë-shërbimit për detyra të tilla si rinovimi i licencës, pagesa e taksave dhe tarifave si dhe dorëzimi i ofertave për kontratat e prokurimit. Edhe pse niveli i interaktivitetit është i një madhësie më të lartë se iniciativat e fazës së dytë, aktivitetet ende përfshijnë një fluks informacioni që është kryesisht i njëanshëm qoftë për qeverinë ose për klientin në varësi të veprimtarisë. Përgjigjet elektronike janë përgjithësisht shumë të rregulluara që të krijojnë rezultate të parashikueshme (p.sh., duke aprovuar rinovimin e licencës, krijimin e një dëftese duke pranuar një ofertë).

Transformimi

Rendi më i lartë i evolucionit për nismat e qeverisë elektronike është transformimi. Iniciativat në këtë nivel shfrytëzojnë aftësitë e plota të teknologjisë për të transformuar mënyrën se si funksionet qeveritare janë konceptuar, organizuar dhe ekzekutuar. Nisma të tilla zotërojnë aftësitë e fuqishme të menaxhimit të marrëdhënieve me klientët që kërkojnë trajtimin e një vargu të plotë pyetjesh, problemesh dhe nevojash. Një nga dallimet e këtyre iniciativave është se ato lehtësojnë rrjedhat e informacioneve dhe vendimmarrjeve bashkëpunuese ndërmjet partnerëve shtetëror, lokal, publik dhe privat. Me fjalë të tjera, nismat e qeverisjes transformuese shpesh kërkojnë të heqin barrierat organizative që promovojnë zgjidhjet me qendër në agjensi dhe në vend të tyre të promovojnë zgjidhje të përqendruara tek klientët.




Figura 3: 4 fazat e zhvillimit të E-Qeverisjes nga Gartner

Burimi: (Sharif N As-Saber, Aashish Srivastava, Khalid Hossain, 2006)

2.4 Teknologjia në E-Qeverisje

Për të qenë të suksesshëm, qeveritë elektronike duhet të krijojnë një infrastrukturë të teknologjisë informative që është optimizuar për të mbështetur kërkesat e reja. Në një qeveri elektronike infrastruktura është tërësia e mjeteve që mundësojnë ekzekutimin e qeverisë. Ndërsa mjetet e kërkuara për të mbështetur një proces qeveritar mund të ndryshojnë nga shembulli në shembull, një infrastrukturë e qeverisë elektronike është përgjithësisht i qëndrueshëm dhe përmban përbërësit e mëposhtëm:

- Infrastruktura e rrjetit
- Infrastruktura e sigurisë
- Mjedisi i serverit të aplikimit

- Mjetet e administrimit të të dhënave dhe përmbajtjes
- Mjetet e zhvillimit të aplikacionit
- Hardware dhe sistemet operative
- Platforma e menaxhimit të sistemeve

Këta përbërës duhet të plotësohen me procedurat operative, dhe nga njerëz që instalojnë, lançojnë, operojnë dhe mirëmbajnë ato, në mënyrë që të siguroheni që nivelet e shërbimit të kërkuara janë themeluar dhe mirëmbajtur për të funksionuar me sukses.

Iniciativat për një qeveri elektronike të suksesshme do të mbështeten në një infrastrukturë që plotëson tre kriteret vijuese:

- **Fleksibiliteti** - për të mbështetur modelet me zhvillim të shpejtë të qeverisë elektronike përmes shtimit të funksionalitetit të ri të aplikacionit dhe integrimin e sistemeve dhe aplikacioneve me përbërësit, partnerët, furnitorët dhe punonjësit.
- **Shkallueshmëria** - për të akomoduar luhatje të paparashikueshme në kërkesa përbërëse dhe ngarkesën e punës së përdoruesve.
- **Besueshmëria** - për të ndihmuar në sigurimin, funksionimin e vazhdueshëm dhe disponueshmërinë e aplikacioneve të qeverisë elektronike për përdoruesit.

2.4.1 Kriteret për dizajnin e një infrastrukture për E-Qeverisje

Fleksibiliteti

Miratimi apo adoptimi i qeverisë elektronike është proces evolues. Ndërmarrjet publike dhe private, zakonisht fillojnë me implementime më të thjeshta, duke u rritur në mënyrë komplekse ndërsa bëhet modeli i biznesit i integruar me internetin. Për të mbetur i suksesshëm në këtë model evolues të bizneseve, është e nevojshme të krijoni një infrastrukturë fleksibile për qeverisjen elektronike. Për të filluar, në listën e mëposhtme së karakteristikave të infrastrukturës mund të jenë të përfshira:

Lidhshmëria universale përmes përdorimit të standardeve të hapura. Në një mjedis qeverisjeje, ndërmarrjet qeveritare do të duhet të lejojnë palët e interesuara, përbërësit (qytetarët dhe bizneset), partnerët, furnitorët, qeveritë e tjera dhe nivelet e tjera të qeverisë, të kenë qasje në sistemet dhe aplikacionet përmes një larmie pajisjesh hyrëse

dhe qasje në bashkëveprimin e aplikacionit. Është e rëndësishme për të përdorur një standard të hapur të qasjes duke përdorur Standardet e Internetit siç është Protokollin e Kontrollit të Transmisionit / Protokollin e Internetit (TCP / IP) dhe shtresat e sigurta të foleve (SSL) për komunikime me HTML / Java dhe eXtensible Gjuha e Markupit (XML).

Një qasje e bazuar në komponentët për zhvillimin e aplikacionit. Zhvillimi i shpejtë i aplikacionit dhe aftësia për të ripërdorur pjesët ekzistuese të aplikacioneve do të përshpejtojnë shumë procesin e krijimit të aplikacioneve të reja të qeverisjes me funksionin dhe lidhjet e kërkuara. Pavarësisht nga ndërtimi apo blerja e aplikacioneve, qeveritë duhet të hetojnë mjete për zhvillimin e aplikacioneve që lejojnë krijimin e aplikacioneve në blloqe ndërtimesh më të vogla (zakonisht të referuara si “komponentët e aplikacionit”), ose të paktën përshtatur me kërkesat individuale të modelit të qeverisë.

Një qasje e bazuar në komponentët për hartimin e infrastrukturës. Infrastruktura qeveritare do të duhet të zhvillohet me ndryshimin dhe përgjegjësitë, përparësitë dhe aktivitetet e qeverisë. Duke iu përmbajtur standardeve të hapura në përzgjedhjen e elementeve të infrastrukturës, elementët mund të trajtohen si përbërës individualë, pa rrezikuar ndërveprimin. Kjo qasje lejon që qeveritë të evoluojnë infrastruktura gradualisht - duke shtuar komponentë harduerësh ose softuerësh, azhurnimi i serverave ekzistues ose heqjen e elementeve të infrastrukturës kur është e nevojshme.

Integrimi me shërbimet e brendshme dhe të jashtme. Ndërveprimin - ndarjen ose komunikimin me teknologjitë e përziera përtej dhe më gjerë ndërmarrjes do të jetë një faktorë i rëndësishëm i suksesit në qeverisjen elektronike. Duke bërë integrimin e aplikacioneve dhe të dhënave midis përbërësve, furnitorëve, partnerëve dhe të punësuarve, qeveritë mund të arrijnë një model të qeverisjes elektronike më efektive dhe më efikase. Mundësimi i integritit realizohet duke përdorur elemente të infrastrukturës së bazuar në standarde të hapura në lidhje me integrimin, i cili lejon funksionimin ekzistues të aplikacionit të integruar në logjikën e re të aplikimit. Duke ndjekur një qasje të bazuar në komponentë për zhvillimin e aplikacionit dhe hartimin e infrastrukturës, duke siguruar integrimin midis sistemeve dhe aplikacioneve të ndryshme, si dhe mundësimin e hyrjes universale në aplikacione (me standarde të hapura si parimi që i bën të gjithë të punojnë së bashku), qeveritë do të krijojnë një infrastrukturë fleksibile që do të zhvillohet dhe do të mbështes kërkesat e tyre të biznesit.

Shkallueshmëria

Një nga sfidat më të mëdha në ndërtimin e një infrastrukture të qeverisë elektronike të besueshme është parashikimi i kërkesës që do të duhet për mbështetje. Kjo është veçanërisht e vërtetë për qeveritë që ndërlidhin drejtpërdrejt me përbërësit e tyre dhe të tjerët: numri i përdoruesve që njëkohësisht i qasen sistemit, plus ngarkesën e punës që ata do të krijojnë, mund të jenë shumë të vështira për t'u parashikuar. Nëse një iniciativë e qeverisë elektronike është e suksesshme, baza e klientëve do të rritet me shpejtësi në qindra mijëra përdorues në një kohë relativisht të shkurtër. Edhe me një bazë statike të përdoruesit, siç është aplikacioni i një qeverie të brendshme, dhe në varësi se kur përdoruesit mund të hyjnë në aplikacione, kërkesa mund të luhetet në masë të madhe gjatë një jave apo edhe një dite të vetme.




Figura 4: Disa ngarkesa tipike në një website gjatë një periudhe 24-orëshe (“IBM analysis for four e-business websites”)

Burimi:

(IBM, 2001)

Një infrastrukturë e shkallëzuar e qeverisë elektronike duhet të jetë e aftë të trajtojë rritjen e ngarkesave të punës duke ruajtur disponueshmërinë e lartë dhe kohën e reagimit të mirë - pa shtuar kompleksitet të rëndësishëm ose pa kërkuar burime të rëndësishme domethënëse. Shkallueshmëria është e rëndësishme, sepse ndihmon krijimin e rritjes të aftësisë së IT në proporcion me nevojën, pa periudha të gjata të kapacitetit të tepërt.

Një infrastrukturë efektive e qeverisë elektronike duhet të jetë lehtësisht e konfigurueshme, përbërësit dhe karakteristikat e menaxhimit janë shumë të rëndësishme në zgjerimin e infrastrukturës. Disa pretendojnë se sistemet e tyre janë të shkallëzueshme, por të gjithë shpesh kërkojnë që proceset e tjera të shoqëruesve dhe personeli mbështetës të rritet me të njëjtën normë si përbërësit teknikë - të cilat mund të jenë të kushtueshme. Për shembull, një qasje e zakonshme teknike për t'u rritur Kapaciteti i serverit është që të ekzekutojnë shumë website paralelisht në internet. Ndërsa kjo mund të jetë një qasje fillestare e shëndoshë për të përmbushur kërkesat e rritura të shkallëzimit, ajo mund të mos jetë aq efektive në trajtimin e rritjeve shumë të mëdha të ngarkesës së punës ose llojeve më komplekse të aplikacioneve. Me këtë qasje, si nevojë fuqia përpunuese vazhdon të rritet, qeveritë mund të detyrohen të shtojnë servera. Kjo do t'i shtonte kohë të kënaqshme dhe shpenzime të konsiderueshme për mirëmbajtjen e serverave dhe për t'i bërë të gjitha aplikacionet në përputhje me këto makina.

Qasjet alternative që rritin shkallëzueshmërinë janë:

- Zhvillimi i aplikacioneve në sistemet jo-pronësore për të akomoduar kapacitetin e shtuar të serverit pa rritur numrimin e serverëve dhe stafit përkatës të TI në mënyrë dramatike. Aplikacionet e ndërtuara rreth një arkitekture jo-pronësore mund të zhvendosen nga një platformë serveri në një më të fuqishme dhe më të shkallëzuar pa pasur nevojë të rishkruhen aplikacionet.
- Ndërtuar në balancimin e ngarkesës, e cila lejon qeveritë të trajtojnë shumë servera si një sistem i vetëm logjik, ku dështimi, heqja ose shtimi i një makine të vetme nuk kërkon ndryshime në mjedisin ekzistues. Këto mundësi, kur merren parasysh në mënyrë aktive, mund të ndihmojnë në shmangien e nevojës për të zëvendësuar komponentët apo ndryshimin e proceseve me secilin përparim ose kërkesë të re.

Besueshmëria

Kur kombinohen fleksibiliteti dhe shkallëzimi kontribuojnë në suksesin e një kriteri të tretë, besueshmëri apo disponueshmëri. Besueshmëria është veçoria e jashtme e E-Qeverisjes, pjesa nga e cila zgjedhësit shohin, presin dhe varen. Kur infrastruktura e qeverisjes elektronike bëhet e penguar, jo e besueshme dhe e padisponueshme për shkak të ngadalësimeve ose shkeljeve të sigurisë - përvoja e përbërësve dhe arsyetimi për ndërmarrjen e nismës së qeverisë elektronike kërcënohet. Vetëm përmes planifikimit të duhur të fleksibilitetit, shkallushmërisë, mund të krijohen besueshmëria dhe disponueshmëria.

2.4.2 Infrastruktura e Teknologjisë informative në E-Qeverisje

Në mënyrë që një mjedis i TI të sigurojë fleksibilitetin, shkallushmërinë dhe besueshmërinë e kërkuar, qeveritë duhet të zhvillojnë një lloj të ri të IT infrastrukturës. Kjo infrastrukturë duhet të përbëhet nga ndërfaqe të hapura që lejojnë aplikacionet dhe shërbimet e reja të lidhen lehtësisht. Mund të lejojë gjithashtu trajtimin dhe administrimin individual të elementeve brenda infrastruktures, përfshirë menaxhimin e mjedisit të përgjithshëm.

Projekti i infrastrukturës të IT përbëhet nga pesë funksione logjike:

- Serverët e aplikacioneve në internet (Web)
- Drejtoria dhe Shërbimet e Sigurisë
- Serverët Edge
- Serverët e të dhënave dhe transaksioneve
- Menaxhimi i ruajtjes

Edhe pse këto pesë funksione mund të zbatoheshin në një apo më shumë servera, ndarja e funksioneve do të lejojë një ndryshim më të shpejtë të infrastrukturës - forcimi i një funksioni të vetëm pa humbjen e ndërveprimit të pjesëve të tjera brenda infrastrukturës.




Figura 5: Projekti i infrastrukturës së IT për një e-qeverisje

Burimi:

(IBM, 2001)

Serverët e aplikacioneve në Internet (Web)

Në zemër të infrastrukturave të qeverisë elektronike janë serverët e Web Aplikacioneve. Përbëhen nga hardueri i serverit, një sistem operativ për serverin dhe një aplikacion softverit i serverit, serverët e Aplikacionit Web drejtojnë logjikën e aplikimit të qeverisë dhe menaxhojnë bashkëveprimet e përdoruesve. Ndërsa një server i vetëm i aplikacionit në internet mund të jetë i mjaftueshëm për shumë, të tjerët mund të implementojnë shumë server që përdoren për optimizimin e një funksioni specifik ose sigurojnë tepriçë dhe shkallëzim.

Gjithnjë e më shumë, është duke u bërë e rëndësishme veçimi i logjikës së prezantimit nga logjika e aplikacionit në këta serverë. Infrastruktura e serverit mund kryej punën e përpunimit në disa faza, duke lejuar shërbimin e informacionit statik, ose transaksioneve shumë të thjeshta me dinamikë të lehtë për të dhënat në front-end. Në këtë mënyrë, qeveritë nuk kanë pse të ngarkojnë aplikacionet më komplekse që funksionojnë në front-end/in e sistemit. Për të mundur proceset e reja të qeverisjes elektronike, serverat e

aplikacionit Web duhet të sigurojnë aftësi gjithëpërfshirëse për integrimin me sistemet e tjera që lidhen me njëri-tjetërin si dhe duhet të sigurojnë sistemet e trashëgimisë së back-end.

Serverët Edge

Serverët Edge të rrjetit janë shfaqur si një funksion i vetëm i një platforme me kosto efektive. Ata kryejnë shumë funksione llogaritëse që ekzistojnë midis infrastrukturës së brendshme të qeverisë elektronike dhe menaxhimit të jashtëm të Internetit, ruterit, autentifikimit themelor, mbrojtjes së firewall dhe transkodimit me aftësinë për të mbështetur llojet e pajisjeve të reja dhe të ofrojë të dhëna dalëse në Internet në formatin e vet paisjeve. Serverat Edge gjithashtu përmirësojnë performancën në fushat e caching (fshehjes), ngarkesës së balancimit dhe komunikimin e sigurtuar. Kjo është e rëndësishme, për transaksionet që trajtohen aktualisht në një rrjet privat dhe që kalojnë në rrjete private virtuale mbi linjat publike.

Siguria

Kërkesat e sigurisë po ndryshojnë gjithashtu. Edhe pse shumë qeveri në faqet e internetit kanë zbatuar autorizimin themelor të fjalëkalimit, sistemet komplekse të qeverisjes do të kërkojnë një mjedis më të sofistikuar prapa firewall, përtej autorizimit themelor. Kjo po shkakton që funksionet e sigurisë të kalojnë nga fjalëkalimet e thjeshta në certifikata dixhitale, të cilat përveç që sigurojnë vlefshmëri individuale të përdoruesit, ofrojnë edhe nivele të ndryshme të vlefshmërisë, në varësi të aplikacionit ose të qasjes së të dhënave.

Hapi tjetër në siguri është arritja e sigurisë bazuar në menaxhimin e politikave. Një server i menaxhimit të politikave siguron hyrje të vetme dhe globale në sisteme të shumta, të cilat mund të eliminojnë nevojën për fjalëkalimet e shumëfishta. Serveri i menaxhimit të politikave gjithashtu administron sigurinë në mënyrë të pavarur nga secili aplikacion individual, me autorizim të administruar dhe menaxhuar në një pikë të vetme si një shërbim i përbashkët për ndërmarrje. Përmes përdorimit të një sistemi të sigurisë të bazuar në politikë, qeveritë krijojnë një qasje të shtresuar ndaj sigurisë, duke ofruar shkallë më të lartë mbrojtjeje kundër hyrjes së paautorizuar.

Serverët e të dhënave dhe transaksioneve

Krijimi i një infrastrukture fleksibile dhe të besueshme të qeverisë elektronike kërkon integrim pa probleme midis serverëve të aplikacionit Web dhe të dhënave të back-end si dhe serverëve të transaksioneve. Këta serverë trajtojnë ngarkesat e punës përpunuese dhe kritike për misionin. Ata ofrojnë shkallë të lartë të sigurisë dhe integritetit së aplikacionit, dhe kanë aftësinë për të kryer transaksione komplekse kundër vëllimeve të mëdha të të dhënave. Shkallueshmëria në këta serverë nuk arrihet duke shtuar pajisje (hardware) shtesë të serverit, përkundrazi, nga rritja e kapacitetit të sistemit ekzistues.

Menaxhimi i ruajtjes së të dhënave

